



Pranimi / Dorezimi Priljena/Prodato Received/Delivered	11-05-2022	2	viti god year
Organ /Pjesa Organ /Jedinka Org /Unit	Nr /Prat Br /Prat Prat No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	2721/2022		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 290/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Zyrta i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.290/2021 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "vërejte me shkrim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.290/2022 e datës 28.03.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET, vërejtja me numër 04/201 e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës me datë 16.03.2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 28.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar me numër protokollit 1622/2022 me pretendimet ankimore se vërejtja me shkrim e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës me datë 16.03.2022 është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat



e ligjit për Zyrtarë Publikë, shkeljeve esenciale të procedurë si dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike e zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.04.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Malishevës, ndërsa me datë 27.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 28.03.2022, e parashtruar nga ankuesja me numër protokolli 1622/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetje e datës 16.03.2022, me numër protokolli 04/201, e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa; Kërkesë e datës 17.03.2022, me numër protokolli 04/2013; e- maili i datës 15.04.2022;Përshkrimi i detyrave të punës; dëshmi për vijueshmërinë në punë për ankuesen Akt Emërimi i datës 16.07.2020; Përgjigje në ankesë e datës 22.04.2022, me numër protokolli 2351/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Bazuar në ankesën e ankueses e cila pretendon së Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës, i ka shqipëruar vërejte me shkrim me datë 16.03.2022, për arsye të mungesës në punë, pasi që ka analizuar pretendimet ankimore të ankueses të gjitha provat dhe faktet relevantë lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses, janë të bazuara në dispozita ligjore në fuqi.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se : "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit". Andaj bazuar në këtë përcaktim ligjor, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se me asnjë provë nuk është argumentuar përgjegjësia disiplinore që i është ngarkuar ankueses respektivisht nuk ka dëshmi lidhur me veprimi apo mosveprimin e paligjshëm të ankueses, ndodhjen e dëmit, respektivisht pasojës së shkaktuar nga veprimet e ankueses si dhe ekzistimin e lidhjes shkakorë në mes të veprimit/mosveprimit të ankueses dhe dëmit/pasojë, kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka marr si provë regjistrimin e vijueshmërisë në punë të datës 15.03.2022, me të cilën konstatohet se ankuesja me këtë datë në mëngjes është regjistruar në ora shtatë e pesëdhjetë e nëntë minuta (7:59), ndërsa në ora njëmbëdhjetë e pesëdhjetë e shtatë minuta (11:57) ka dal në pauzë, po ashtu në fund të orarit për dalje nga puna ankuesja është regjistruar në ora pesëmbëdhjetë e pesëdhjetë e tetë (15:58), andaj



mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se vërejtja e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës, është nxjerrë edhe në kundërshtim me nenin 50, paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore", ndërlidhur me nenin 46 paragrafin 1 dhe 4, nën paragrafët 4.1, 4.2; 4.3 dhe 4.4 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar" pasi që vërejtje e shqiptuar me arsyetimin se ankuesja nuk e ka respektuar orarin e punës në zyre me datë 15.03.2022 është i paqëndrueshëm dhe i paargumentuar me prova dhe fakte. Po ashtu, Kolegji thekson se nuk mundet të llogaritet si mungesë në punë për datën 15.03.2022 për arsye se ankuesja nuk është regjistruar në sistemin elektronik pas kthimit nga pauza, siç i kishte shqiptuar vërejtjen me shkrim Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës, nga rrjedh se vërejtja me shkrim e shqiptuar ndaj ankuses me datë 16.03.2022 është në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore në fuqi dhe si e tillë duhet të shfuqizohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuses e cila pretendon se nuk ka munguar në punë, pasi ka administruar provën relevante përkatësisht dëshminë për vijueshmërinë në punë për datë 15.03.2022, ka konstatuar se ankuesja ne rastin e regjistrimit të vijueshmërisë në punë me datë 15.03.2022, ka vepruar në pajtim me nenin 8, paragrafi 1, të Rregullores (QRK) NR.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: "1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave thekson faktin se Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar që të shuaj dhe ta largojë nga dosja personale e ankuses vërejtjen me shkrim të shqiptuar me datë 16.03.2022 nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës në pajtim me obligimet ligjore të përcaktuara me nenin 51 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Deklarimi i shuarjes bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës", pasi që Kolegji bazuar në arsyetimin e dhënë si më lartë ka konstatuar se vërejtja ndaj ankuses është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-



048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.


## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

A.nr. 290/2022

Rushit KAJTAZI

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

Ankueses

Kryetarit të Komunes se Malishevës;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës;

Arkivit të KPMSHCK-së,